



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3639/12 prot.

Datë 26.01.2026

V E N D I M
Nr.141/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.01.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të KPP nr. 48/2026, datë 12.01.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me REF-64014-10-08-2025, me objekt: “Hartimi i planit të mbarështimit të ekonomive pyjore dhe kullosore (Ekonomia pyjore Kaçinar), Bashkia Mirditë”, me fond limit 12,616,500.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 20.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Deja” SHPK, me NIPT K37509969C dhe adresë: Lagja Nr.1, Rruga Strasburgu Nr 21, Kamëz, Tiranë.

Subjekt i interesuar: Operatori ekonomik BOE “Lorenzo & Co” SHPK “Sphaera” SHPK me NIPT J61903071B, J81809003U dhe adresë: Rruga Dritan Hoxha, Pallati i Ri 8 - katesh, perballe Procredit Bank, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Mirditë.
Adresa: Sheshi “Abat Doçi”, Rrëshen.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit

Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 12.01.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.48/2026 ku vendosi:

1. *Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Deja” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me REF-64014-10-08-2025, me objekt: “Hartimi i planit të mbarështimit të ekonomive pyjore dhe kullosore (Ekonomia pyjore Kaçinar), Bashkia Mirditë”, me fond limit 12,616,500.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 20.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.*
2. *Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik BOE “Lorenco & Co” & ‘Sphaera’ SHPK, duke e skualifikuar atë, në zbatim të vendimit të KSHA nr.146, datë 29.12.2025.*
3. *Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Deja” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.*
4. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
5. *Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik, “Deja” SHPK.*
6. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
7. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 346/1prot., datë 22.01.2026 protokolluar me tonën nr. 3639/9 prot., datë 23.01.2026 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.48/2026 datë 12.01.2026, për procedurën e prokurimit E hapur”, me REF-64014-10-08-2025, me objekt: “Hartimi i planit të mbarështimit të ekonomive pyjore dhe kullosore (Ekonomia pyjore Kaçinar), Bashkia Mirditë”, me fond limit 12,616,500.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 20.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1 Me shkresën nr. 346/1prot., datë 22.01.2026 protokolluar me tonën nr. 3639/9 prot., datë 23.01.2026 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.48/2026 datë 12.01.2026, për procedurën e prokurimit E hapur”, me REF-64014-10-08-2025, me objekt: “Hartimi i planit të mbarështimit të ekonomive pyjore dhe kullimore (Ekonomia pyjore Kaçinar), Bashkia Mirditë”, me fond limit 12,616,500.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 20.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi veprimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, lidhur me zbatimin e vendimit Nr.48/2026 datë 12.01.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga ky verifikim rezultoi se, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim të procedurës object ankimi, në zbatim të vendimit Nr.48/2026 datë 12.01.2026, të këtij komisioni.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit E hapur”, me REF-64014-10-08-2025, me objekt: “Hartimi i planit të mbarështimit të ekonomive pyjore dhe kullimore (Ekonomia pyjore Kaçinar), Bashkia Mirditë”, me fond limit 12,616,500.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 20.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

